

# SUPERFLUID-21M1M EKO

*Super-plastifikues për beton, i punuar në bazë karbo-aksilate.  
Përgjigjet në: EN 934-2T11.1&T11.2*

## Fusha e aplikimit:

- Super-plastifikues i dedikuar për prodhim të betoneve që transportohen te të cilat kërkohet mbajtje afatgjate në formë përpunimi dhe karakteristika aerologjike të betonit të freskët;
- Superfluid-21M 1M EKO mundëson shkallë të lartë të reduktimit të ujit në betonin, si dhe të prodhimit të betoneve shpërndarëse, me klasë të lartë të konsistencës;
- Mundëson mbajtje afatgjate të konsistencës së betonit (deri 180 min.);
- Superfluid-21M 1M EKO është i përshtatshëm për përgatitje të betoneve të dedikuara për vendosje me pompe në lartësi dhe gjatësi të mëdha, betonim të prerjeve me armaturë të dendur;
- Prodhimi i betoneve të dedikuara për transport të zgjatur dhe për aplikim në kushte të temperaturave të larta ambientale;
- Prodhim i betoneve me karakteristika të larta të fortësisë fillestare dhe asaj përfundimtare
- Prodhim i SCC – betonit;

## Cilësi:

- Reduktim i ujit deri 20%;
- Karakteristika të shtuara të fortësisë fillestare dhe përfundimtare;
- Homogjeniteti dhe koherenca e përmirësuar e përzierjes së freskët të betonit;
- Mos-depërtueshmëri e shtuar e betonit;
- Rezistencë e shtuar në veprimin e akullit dhe të kripërave;
- Qëndrueshmëri e shtuar e betonit;
- Rezistencë e shtuar e betonit në karbonizim;
- Rezistencë e shtuar e betonit në ndikesa atmosferike;
- Aplikim i lehtësuar i betonit;

## Karakteristika teknike

CILËSI	METODË	VLERË E DEKLARUAR
Dukje	Vizuale	Lëng me ngjyrë të verdhë të çelë
Masë volumi (në 20°C)	ISO 758	(1.05 ± 0.02) g/cm <sup>3</sup>
Përmbajtje e klorideve	EN 480-10	≤ 0.1 %
Përmbajtje e alkaleve	EN 480-12	≤ 2 %
pH vlerë	ISO 4316	6 - 8

## Dozim dhe performansa:

Dozim optimal i Superfluid 21M1M EKO është prej 0,4 deri 1,2 % nga masa e çimentos në përzierjen e betonit. Në rast të dozimit të tillë arrihet reduktim i ujit prej 15% deri 20%.






Diagram 1

Me këtë rast, në mënyrë përkatëse arrihet rritje e karakteristikave të fortësisë fillestare dhe përfundimtare të betonit.



Në rastin kur punohet në kushte të temperatura të larta dhe në rast të transportit dhe vënies së zgjatur të betonit, rekomandojmë dozim më të lartë të Superfluid- 21M1M EKO (mbi 0,8% nga masa e çimentos). Betoni i freskët gjatë prodhimit duhet të përgatitet me klasë më të lartë të konsistencës - S4 ose S5. Gjatë kushte të zakonshme të temperaturave (deri 25° C), betoni i përgatitur me Superfluid - 21M1M EKO mund të transportohet dhe vendoset me pompë në periudhë deri 180 minuta.



Gjatë temperaturave ekstreme të larta ambientale, ose në rast kur prodhimi, transporti dhe vendosja e betonit zgjat më tepër se tre orë, në përzierjen e betonit krahas Superfluid - 21M1M EKO, rekomandohet të shtohet/dozohet aditiv për ngadalësim të lidhjes së betonit Usporuvaç-D2, me dozim i cili varet nga kushtet konkrete.

Dozimi i aditivëve bëhet në mënyrë manuale ose automatike gjatë prodhimit të betonit.

Efekt më i mirë arrihet kur Superfluid - 21M1M EKO shtohet bashkë me 20 – 30 % nga uji i nevojshëm në betonin, në agregatin paraprakisht të përzier, çimento 70 – 80% nga sasia e nevojshme e ujit në betonin.

Kohëzgjatja e përzierjes së masës së freskët të betonit me shtimin e Superfluid - 21M1M EKO nuk duhet të jetë më e shkurtër se 90 sekonda.

#### Efekte nga tej-dozimi:

Dozimi i tejet i lartë i Superfluid - 21M1M EKO mund të shkaktojë segregacione (plasartije) te betoni.

#### Kompatibiliteti:

Superfluid - 21M1M EKO është kompatibel me më tepër aditivë nga programi i Ading nga grupi i përshpejtuesve dhe ngadalësuesve, aditivë për betonim dimëror, aditivë për mos-depërtueshmëri ndaj ujit, aerantë dhe ngjashëm. Nëse në përzierjen e betonit përdoren në të njëjtën kohë dy ose më tepër aditivë, nevojitet të bëhen hulumtime paraprake.

Aditivët e ndryshëm në betonin dozohen ndaras (nuk përzihen mes vete para se të vihen në përzierjen e betonit). Superfluid - 21M1M EKO është kompatibel me të gjitha llojet e çimentos (përfshirë edhe betonet sulfato-rezistent).

Superfluid - 21M1M EKO nuk është kompatibel dhe nuk guxon të përdoret me aditivë të cilët përmbajnë polinaftalensulfonat, siç janë Fluiding, Superfluid, Superfluid – M1, Superfluid-M1M1 dhe Hidrofob-T.

#### Paketimi:


Në govata plastike prej 5 dhe 20 kg  
Në fuçi 200 kg  
Në kontejner 1000 kg

#### Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell, në temperaturë prej +5° C deri +35° C

AFATI I PËRDORIMIT: 12 muaj.

#### CE shenjë

 2032	
<b>ADING AD Shkup</b> Novoselski pat (rr. 1409) nu. 11, 1060 Shkup, Republika e Maqedonisë	
14	
<b>2032-CPR-08.40A</b> <b>EN 934-2:2009</b>	
<b>SUPERFLUID-21M1M EKO</b> Aditiv për beton, Superplastifikues/ngadalësues <b>EN 934-2: T11.1&amp;11.2</b>	
Përmbajtje maksimale e klor jonëve:	0.1%
Përmbajtje maksimale e alkaleve:	2.0%
Veprim korroziv:	<b>Përmban komponente vetëm nga EN 934-1:2008, Aneks A.1</b>

**Rrezik për jetën:** Superfluid-21M1M EKO nuk përmban materiale toksike, por edhe krahas kësaj nevojitet të kihet kujdes materiali të mos vjen në kontakt me lëkurën, sytë ose të mos gjëllitet. Në rast të kontaktit me lëkurën ose me sytë, nevojitet që menjëherë ato të shpëlahen me ujë të pastër rrjedhës. Nëse gjëllitet, nevojitet të kërkojmë ndihmë mjekësore. Informacionet shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.

**Zjarr:** Superfluid-21M1M EKO është lëng që nuk ndizet. Informacionet shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.

**Pastrimi dhe vendosja në depo:** Mbetjet e Superfluid-21M1M EKO pastrohet me ujë. Ambalazhi i vjetër i shfrytëzuar duhet të vendoset në depo sipas rregullatave lokale për atë lloj mbetjeje. Informacionet shtesë janë dhënë në Fletën e sigurisë së prodhimit.